



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT ENUAR V MERKO
ZYRA PËRMBARIMORE E.G BAILIFF SERVICE

Adresa: Rr. Ibrahim Rugova, Pallati 64, Hyrja 8, Ap. 1, Tiranë Cel- +355 67 20 27 580, Tel +355 4 22 31 888

Nr. 6241 .Prot

Tiranë më 04.04.2018

URDHËR
PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar: QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

TIRANË

Në Tiranë sot më datë 04.04.2018.

Unë **Enuar V MERKO** Përmbaues Gjyqësor Privat me Liçensë Nr.123 pasi studiova dosjen përmbaimore Nr.622 datë 10.01.2018 si dhe në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 2112 Vendimi, datë 14.12.2017 të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë.

KONSTATOVA

Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut në cilësinë e kreditorit, ka paraqitur pranë **Zyrës Përmbaimore E.G BAILIFF SERVICE me Përmbaues Gjyqësor Enuar V MERKO**, kërkesën për ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv, Akt Administrativ Nr.278, datë 09.08.2017 së bashku me Urdhërin e Ekzekutimit Nr. 2112 Vendimi, datë 14.12.2017 të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë me palë:

- **Kreditor** : Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut
- **Debitor** : Shoqëria tregtare "SOLEIL & SEA" Sh.P.K.
- **Me objekt** : Pagim Shume

Pasi janë zbatuar procedurat ligjore të njoftimit drejtuar palës debitore për ekzekutim vullnetar të detyrimit, pala debitore nuk ka kryer ekzekutimin vullnetarisht te detyrimit që përmban Titulli Ekzekutiv, Akt Administrativ Nr.278, datë 09.08.2017.

Me vendim të Përmbauesit Gjyqësor Privat ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv, Akt Administrativ Nr.278, datë 09.08.2017 ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm.

Me Urdhërin nr. 317 dt. 19.03.2018 është urdhëruar vendosja e sekuestros ekzekutive në llogarinë e debitorit në bankën Credins për përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit Inspektoriati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut.

Në këto kushte ekzekutimi i urdhërit të ekzekutimit duhet pushuar si i ekzekutuar tërësisht.



Nga sa më sipër si dhe mbështetur në nenin 616/a të Kodit Proçedurës Civile dhe në nenet 31 gërma b, 32 gërma c dhe nenin 46 të Ligjit nr.10031 datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”.

URDHËROJMË

1. Heqjen e masës së sekuestros konservative mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga pala debitore Shoqëria tregtare “SOLEIL & SEA” Sh.P.K. identifikuar me Nr.NIPT: L21926005F.
2. Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brënda afatit ligjor.
3. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të Kodit të Procedurës Civile (parag.II) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT
ENUAR V MERKO**

